



Pranuar / Dorezuar Priljeño/Prodato Received/Delivered	18-01-2023	3	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPMSHICK	451/2023		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1099/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1099/2022 të datës 05.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me numër protokoli 4747 të datës 07.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “ *masë disiplinore/largim nga shërbimi civil*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si pa bazuar ankesa me numër A.nr.1099/2022 e datës 05.12.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoli 4747 i datës 07.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 05.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 7633/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 4747 të datës 07.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për shkak shkeljeve të dispozitave procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.12.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të

ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 13.12.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7633/2022 e datës 05.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin për përfaqësim i datës 01.08.2022; Vendimin me Nr. Ref: 376/2013 i datës 01.08.2013; Vendimin me Nr.66/09 i datës 23.11.2009; Vendimin me Nr. 891/2018 i datës 05.11.2018; Vendimin me Nr.Ref:87/2018 i datës 24.07.2018. Vendimin me numër ZSP 82/2018 i datës 02.07.2018; Vendimin me Nr.476/2021 i datës 01.12.2021; Vendimin me Nr. Ref:129/2022 i datës 21.04.2022; Vendimin me Nr. Ref:237/2022 i datës 22.07.202 nga Komisioni për Grada dhe Disiplinë i MPJD-së; Vendimin me Nr.Ref:466/2022 i datës 22.07.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr.Ref 560/2022 të datës 17.10.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Njoftimin për inicimin e procedurës disiplinore nga Njësia e Burimeve Njerëzore e MPJD për ankuesin e datës 27.10.2022; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 25.10.2022; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor të datës 04.11.2022, 31.10.2022, 28.10.2022; Vendimin me numër protokolli 4747 të datës 07.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Transferimin bankar për Sh.B i datës 04.07.2022; Transferimin bankar i datës 06.07.2022 për H.Sh; Transferimin bankar të datës 04.07.2022 për A.A; Transferimin bankar të datës 05.07.2022 për A.Z-B; Transferim bankar i datës 04.07..2022 për Albi Kulturgemende E.V; Transferim Bankar i datës 04.07.2022 për F.H; Transferim bankar i datës 05.07.2022 për B.C; Transferim bankar i datës 05.07.2022 për Albanische Kultut e.V; Formulari i vlerësimi për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2020 i datës 29.10.2020 për ankuesin; Formulari i vlerësimi për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2019 i datës 30.10.2019 për ankuesin; Shkresë e datës 15.02.2022 nga ankuesi; Shkresë e datës 06.09.2021 nga kryetari i Shoqatës Gjermano-Kosovare; Shkresën e datës 15.02.2022 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme në Baden-Wurttemberg; Shkresën e datës 23.02.2022 nga Kryetarja e Kuvendit të Landit Baden-Wurttemberg; Shkresën e datës 18.02.2022 nga Kryetari i Komunës së Shtutgartit; Shkresën e datës 14.02.2022 nga Kryetarja e Komunës së Fellbach; Shkresën e datës 12.02.2022 nga Shoqata Gjermano-Kosovare; Shkresë e datës 09.02.2022 nga Këshilli qeveritar Kalsruhe për ankuesin; Mesazhe telefoni; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 7847/2022 e datës 09.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 7958/2022 e datës 13.12.2022; Ftesën për seancë dëgjimore e datës 28.10.2022 për ankuesin, për R.M nga Njësia e Burimeve Njerëzore nga MPJD; Ftesën për seancë dëgjimore e datës 31.10.2022 për ankuesin nga Njësia e Burimeve Njerëzore nga MPJD; e-mailin e datës 31.10.2022 nga ankuesi për Njësinë e Burimeve Njerëzore në MPJD; Përgjigjen e datës 31.10.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore e MPJD për ankuesin; Vendimin me Nr.Ref:370/2022 i datës 26.10.2022 për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor; Vendimin me Nr.Ref: 305/2022 të datës 14.09.2022 për plotësim ndryshimin e vendimit të Komisionit Disiplinor; Vendimin me Nr. ref: 77/2022 të datës 14/03/2022 për plotësim ndryshimin e vendimit të Komisionit Disiplinor; Vendimin me Nr. 238/2021 të datës 22.11.2021 për plotësim/ndryshimin e vendimit për themelimin e Komisionit Disiplinor; Raporti lidhur me subvencionin e Qeverisë së BË për mësim plotësues i datës 29.06.2022; Shkresën nga Ministria e Kulturës e Baden-Eurttemberg e datës

24.11.2021; Transaksione bankare datë 01, 03, 07, 04, 15, 14, 02.2022; E-mail nga A.B-Z për L.L e datës 28.06.2022; E-mailin nga S.B e datës 29.06.2022 për L.L; Komunikim telefonik nga Sh.B; Raportin e nën komisionit hetimor i datës 06.07.2022; Vendimin me Nr.221/2022 i datës 01.07.2022 për themelimin e nën komisionit hetimor lidhur me verifikimin e pretendimeve të paraqitura në denoncimin e datës 01.07.2022; Denoncimin mbi dyshimin e bazuar për shkelje të rënda disiplinor nga nga Ambasadori i Republikës së Kosovës në Gjermani për Komisionin për Grada dhe Disiplinë; Deklaratë për komisionin nën hetimor i datës 04.07.2022 nga Udhëheqësja e Konsullatës së Republikës së Kosovës në Shtutgart; E-mailin e datës 05.07.2022 nga Konsullata në Shtutgart për L.L; Dekorativë për komisionin nën hetimor i datës 04.07.2022 nga zëvendës konsulli i Konsullatës së Republikës së Kosovës në Shtutgart; Raporti informuar për nën komisioni hetimor i themeluar nga komisioni për grada dhe disiplinë në MPJ i datës 04.07.2022; Tabela e hyrje/daljeve mujor në llogari bankare për muajin janar-dhjetor 2021; Tabela e hyrje/daljeve në llogari bankare për muajin janar-shkurt 2022; Emailin e datës 05.07.2022 për L.L; Lista e mësuesve 2021-2022; Emailin e datës 15.03.2022 nga H.S për ankuesin; Emailin e datës 29.06.2022, 03.07.2022 nga D.M për L.L; Emailin e datës 29.06.2022 nga L.L për D.M; Emailin e datës 29.06.2022 nga L.L; Emailin e datës 04.07.2022 nga D.M për L.L; Emailin e datës 03.07.2022 nga Sh.B për L.L; Emailin e datës 04.07.2022 nga F.H për L.L; Emailin e datës 28.06.2022 nga Sh.G-B për L.L; Emailin e datës 01.07.2022 nga L.L; Emailin e datës 24.06.2022 nga ankuesi për L.L; Emailin e datës 22.06.2022 nga L.L për ankuesin; Emailin e datës 12.04.2022 nga ankuesin për L.L; Komunikim telefoni; Emailin e datës 25.03.2022 nga L.L për F.A; Shkresë me titull " *Pranim-dorëzimi i detyra nga Këshilltari B.M tek Drejtuesja e Konsullatës së Përgjithshëm*" e datës 22.03.2022; Procesverbal i Komisionit për Grada dhe Disiplinë i datës 20.07.2022; Kërkesën e datës 28.12.2022 të ankuesit për seancë; Njoftimin e datës 13.01.2023 për përfaqësuesin e ankuesit për seancë.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave material rrjedhë së Ambasadori i Republikës së Kosovës në Gjermani më datë 25.10.2022 ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin së i njëjti në cilësinë e Udhëheqësit të Konsullatës së Kosovës në Shtutgart të Gjermanisë, ka kryer shkelje të rëndë të detyrave të punës, pasi që ankuesi nga data 01-12 shkurt 2022 kishte bërë tërheqjen e mjeteve në vlerën 23,940.01 Euro nga llogaria e Konsullatës së Republikës së Kosovës në Shtutgart, gjegjësisht nga fondi i ndarë për mësimdhënësit e mësimin plotësues të gjuhës shqipe nga Landin Baden-Wurttemberg, mirëpo që këto mjete nuk i janë transferuar asnjëherë mësimdhënësive.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me Vendimin me numër protokollit 4747 të datës 07.11.2022, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore "*largim nga shërbimi civil*".

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së Vendimi me numër protokollit 4747 i datës 07.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është nxjerrë me shkelje procedurale

dhe materiale, duke theksuar se ankuesi është gjykuar dy herë për të njëjtën çështje e mbi këtë bazë procedura disiplinore e riinicuar me datë 25.10.2022 është e kundërligjshme në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Tutje, ankuesi në ankesë shton se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë nga organi jo kompetente sepse Ambasadori i Ambasadës së Kosovës në Gjermani nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejt i ankuesit pasi që i njëjti që nga data 21.04.2022 ka qenë i sistemuar në pozitën e Zyrtarit për Trajnim dhe Zhvillim në Akademinë Diplomatike, Komisioni Disiplinor me rastin e vendimmarrjes nuk ka shqyrtuar asnjë provë relevante por vendimin e ka marr duke u bazuar nga urdhrat nga lartë dhe së vendimi i atakuar nuk përmban elementet e përcaktuar me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që sipas arsytimit nuk dihet cilat veprime të ankuesit kane sjellje deri të shkelja e ndonjë dispozite ligjore por vendimi përmban vetëm përshkrim të dokumenteve të deponuar, dhe së në veprimet e ankuesit nuk janë plotësuar në mënyrë komulative të gjitha elementet e përgjegjesisë disiplinore dhe se Komisioni Disiplinor ka shqiptuar masën me të rëndë disiplinore. Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj Vendimin me numër protokollit 4747 të datës 07.11.2022 të Komisionit Disiplinor të MPJD-së, të shfuqizoj masën disiplinore "largim nga shërbimi civil" dhe të detyroj Sekretarin e Përgjithshëm të MPJD-së që ankuesin ta kthej në pozitën e punës Zyrtar për Trajnim dhe Zhvillim dhe ti kompensoj të gjitha pagat dhe benificionet lidhur me marrëdhënien e punës nga data e inicimit të procedurës disiplinore deri në zbatimin e këtij vendimi.

Në kuptim të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë procedurën disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji analizoj nenin 45 më të cilin është përcaktuar se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i dulur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, ndërsa me nenin 46 si shkelje të rënda disiplinore janë përcaktuar: 3.1 mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë".

Lidhur më pretendimin ankimor se Vendimi me numër protokollit 4747 i datës 07.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse për të njëjtën çështje është vendosur nga i njëjti organ me parë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës vlerëson se ky pretendim ankimor është i pabazuar ligjërisht, sepse bazuar në shkresat e administruara të lëndës rezulton

së Ministrja e MPJD-së me Vendimin më numër 4257 të datës 17.10.2022 ka shfuqizuar Vendimin Nr.ref 446/2022 të datës 22.07.2022 lidhur me lirim të ankuesit nga shërbimi civil, duke nënkuptuar së më shfuqizimin e këtij vendimi janë shfuqizuar edhe veprimet juridike administrative që i kanë paraprirë nxjerrjes së Vendimit Nr.ref 446/2022 të datës 22.07.2022.

Ndërsa, përkitazi me pretendimin ankimorë së inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë nga organi jo kompetent sepse Ambasadori i Ambasadës së Kosovës në Gjermani nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit, pasi që i njëjti që nga data 21.04.2022 ka qenë i sistemuar në pozitën e Zyrtarit për Trajnim dhe Zhvillim në Akademinë Diplomatike, Kolegji konstaton së inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është në pajtim të plotë me dispozitat e neni 48 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht kërkesa për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë nga organi kompetent sepse inicimi i procedurës disiplinore i referohet shkeljeve të supozuar të ankuesit gjatë kohës kur ankuesi ka qenë duke ushtruar funksionin diplomatik të shefit të Konsullatës në këtë Ambasadë dhe gjatë kësaj kohë si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit ka qenë iniciuesi i procedurës disiplinore pra Ambasadori i Ambasadës së Kosovës në Gjermani, kështu që pretendim ankimor mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në analizimin e provave të lëndës si dhe të vendimit të goditur më ankesë, ka konstatuar së arsyetimi i Vendimit më numër protokolli 4747 të datës 07.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është në pajtim me dispozitat e neni 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme, pasi që i njëjti përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave si dhe bazën ligjore të vendimmarrjes. Rrjedhimisht nga provat e lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur së Autoritetet e Landit të BW me datë 29.10.2021 kanë miratuar ndarjen e mjeteve në vlerë prej 47.880,00 euro për kompensimin e mësimdhënësve të gjuhës shqipe për vitin shkollor 2021, e të cilat mjete janë transferuar me datë 22.12.2021 në llogarinë bankare të Konsullatës së Kosovës në Shtutgart. Ankuesi në cilësinë e Shefit të Konsullatës dhe njëkohësisht si person i vetëm i ngarkuar për tërheqjen e mjeteve nga llogaria bankare e konsullatës, ka paguar përmes llogarisë bankare dhjetë (10) mësimdhënës, ndërsa i njëjti nga llogaria bankare e konsullatës kishte tërhequr vlerën prej 21,640.01 euro për pagesë të tetë (8) mësimdhënësve të tjerë më qëllim të pagesës në cash (para në dorë), mirëpo bazuar në konfirmimet më shkrim të gjashtë mësimdhënësve të njëjtit nuk kishin pranuar ndonjë pagesë nga ankuesi.

Kolegji i Këshillit duke ju referuar pretendimit ankimor se në veprimet e ankuesit nuk janë plotësuar në mënyrë komulative të gjitha elementet e përgjegjësisë disiplinore, sepse ankuesi shumë e ndara nga Fondi i Autoritetet të Landit të BW i ka shpërndarë në mënyrë të përpikte por në intervale të ndryshme kohorë, Kolegji bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës përkatësisht sipas deklaratës së datës 04.07.2022 të Udhëheqëses së Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Shtutgard ka gjetur së ankuesi me rastin e përfundimit të mandatit diplomatik sipas vendimit me numër 476/2021 të datës 01.12.2021 të Ministres së MPJD, nuk kishte dorëzuar ndonjë dokument që ka të bëjë më mësimin plotësues të gjuhës shqipe në landin e BW, dhe rrjedhimisht me asnjë shkresë nuk vërtetohet fakti së ankuesi me rastin e përfundimit të mandatit të ketë njoftuar apo raportuar Ambasadorin apo pasardhësin në pozitën e Shefit të Konsullatës së

Përgjithshme të RKS në Kosovë lidhur me ecurinë e procesit të pagesave dhe mos pagesave lidhur me mësimin plotësues të gjuhës shqipe për vitin 2021. Për më tepër Kolegji po nga shkresat e lëndës konstatoi së ankuesi kishte realizuar pagesat e mbetura përmes xhiorollogarisë së tij vetëm pas kthimit nga misioni diplomatik fakt ky i pohuar nga vet ankuesi në ankesë, rrjedhimesh pasi informatës lidhur me mos pagesat e tetë mësimdhënëse. Andaj, mbi bazën e këtyre fakteve, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor me rastin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore të ankuesit në kuptim të shkeljes së detyrimeve ligjore ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe po ashtu drejtë ka zbatuar ligjin material, ngase edhe në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit ankuesi me veprimin e tij ka rënë ndeshë me detyrimet e zyrtarit publikë të përcaktuara me nenin 25 paragrafi 1 dhe 3, si dhe nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke konsumuar kështu elementet e shkeljes disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Theksuar i me lart, e duke bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1099/2022.

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të MPJD-së; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

